



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL**

Adresa: Rruga "Abdi Toptani", ish-hotel "Drini", Tiranë

Tel/Fax: 04 2268141; 2268142

Nr. 163 Prot.

Tiranë, më 07.03.2017

**V E N D I M**

**Nr. 45, datë 07/03/2017**

**"Për përfundimin e procesit të mbikëqyrjes në lidhje me administrimin e shërbimit civil në institucionin, Bashkia Krujë"**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11 pika 1, 14 dhe 15, të ligjit nr.152/2013 "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar; neneve 77-118, të ligjit nr. 44/2015 "*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*", si dhe nenit 34 të Rregullores "*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*", miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të Relacionit të Drejtorisë së Çështjeve Ligjore dhe Marrëdhënieve me Jashtë "*Mbi verifikimin e ekzekutimit të vendimit nr. 30, datë 31.03.2016, "Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar ligjshmërinë gjatë administrimit të shërbimit civil, në Bashkinë Krujë"*",

**Vërej se:**

Në zbatim të Vendimit nr.103, datë 23.09.2015, "*Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil, në njësinë e qeverisjes vendore, Bashkia Krujë*", të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, është realizuar mbikëqyrja në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, pranë këtij institucioni.

Ky proces është përmbyllur me vendimin nr.30, datë 31.03.2016, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil "*Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar ligjshmërinë gjatë administrimit të shërbimit civil, në Bashkinë Krujë*", në të cilin është vendosur:

1. Të miratoj raportin përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil, në subjektin, Bashkia Krujë, si pjesë përbërëse të këtij vendimi, si dhe të paralajmëroj institucionin për të rregulluar ligjshmërinë sipas detyrave që do të detajohen në vijim.

2. Njësia përgjegjëse pranë Bashkisë Krujë, duhet të materializojë në strukturë, ndarjen e qartë të pozicioneve të punës që janë pjesë e shërbimit civil, nga funksionet ndihmëse administrative, sipas përkufizimeve të materializuara në nenin 4, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Në vijim të realizimit të kësaj detyre, në zbatim të nenit 2, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, njësia përgjegjëse duhet të tregojë kujdes dhe të veprojë për përfshirjen në shërbimin civil dhe për pasojë, trajtimin si nëpunës civilë, të punonjësve që plotësojnë këto pozicione, të cilët përmbushin kushtet ligjore sipas përkufizimit të punës, duke u mbështetur në orientimet e dhëna në raportin përfundimtar të mbikëqyrjes dhe konkretisht, të emëtuara dhe të ndara sipas njësive administrative, si më poshtë:

- Në Bashkinë Krujë, pozicionet e punës:
  - ✓ “Specialist në Sektorin e Planifikimit të Territorit”  
“Inspektor i Ndihmës Ekonomike”
  - ✓ “Inspektor në Sektorin e Prokurimeve”
  - ✓ “Inspektor në Sektorin Ekonomik”
  - ✓ “Inspektor i Tatim- Taksave”
  - ✓ “Inspektor në Sektorin e Shërbimit Social”
  - ✓ “Inspektor në Sektorin e Arsimit dhe Kulturës”
- Në Njësinë Administrative Fushë-Krujë, pozicionet e punës:
  - ✓ “Inspektor në Drejtorinë e Financës”
  - ✓ “Inspektor Licencimi në Drejtorinë e Tatim-Taksave”
  - ✓ “Inspektor në Drejtorinë e Tatim-Taksave”
- Në Njësinë Administrative Thumanë, pozicionet e punës:
  - ✓ “Përgjegjës i Zyrës së Tatim-Taksave”
  - ✓ “Administrator i Zyrës së Ndihmës Ekonomike”
  - ✓ “Specialist Pyjesh”
  - ✓ “Jurist”
  - ✓ Inspektor Veteriner”
- Në Njësinë Administrative Bubq, pozicioni i punës:
  - ✓ “Specialist Veteriner”
- Në Njësinë Administrative Cudhi, pozicionet e punës:
  - ✓ “Përgjegjës i Zyrës së Bujqësisë dhe Pyjeve Komunale”
  - ✓ “Specialist i Pyjeve Komunal”
  - ✓ “Administrator Shoqëror i Ndihmës Ekonomike”
  - ✓ “Specialist i Paftësisë së Kufizuar”

- Në Njësinë Administrative Nikël, pozicionet e punës:

- ✓ “Inspektor Finance”
- ✓ “Inspektor Urbanistike”
- ✓ “Përgjegjës i Shërbimeve”
- ✓ “Inspektor i Arsimit dhe Shëndetësisë”
- ✓ “Përgjegjës i Sektorit të Tatim-Taksave”
- ✓ “Specialist Tatim-Taksa”

3. Njësia përgjegjëse pranë Bashkisë Krujë, të përfundojë marrëdhëniet e punësimit, duke evidentuar faktin e mospërbushjes së kriterit të nivelit arsimor për të qenë nëpunës civil, sipas ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, për punonjësit të cilët janë me arsim të mesëm, ose që nuk i plotësojnë kriteret arsimore, në lidhje me nivelin e arsimit të lartë, si më poshtë:

- Në Bashkinë Krujë:

- ✓ \*\*\*\*\*, emëruar me aktin nr. 7, datë 30.10.2006, në pozicionin “Inspektore në Sektorin Ekonomik”;
- ✓ \*\*\*\*\*, emëruar me aktin nr. (pa nr. protokolli) në datën 16.04.2003, në pozicionin “Inspektor në Sektorin e Tatim-Taksave”;
- ✓ \*\*\*\*\*, emëruar me aktin nr. 08, datë 01.06.2009, në pozicionin “Inspektor në Sektorin e Tatim-Taksave”;
- ✓ \*\*\*\*\*, emëruar me kontratë pune datë 20.07.2011, në pozicionin “Inspektor në Sektorin e Tatim-Taksave”;
- ✓ \*\*\*\*\*, emëruar me aktin nr. 5, datë 02.10.2006, në pozicionin “Inspektore në Sektorin e Shërbimit Social”.
- ✓ \*\*\*\*\*, emëruar me aktin nr. 05, datë 02.10.2006, në pozicionin “Inspektore në Sektorin e Shërbimit Social”.
- ✓ \*\*\*\*\*, emëruar me aktin nr. 03, datë 13.02.2014, në pozicionin “Inspektor në Sektorin e Arsimit dhe Kulturës”.
- ✓ \*\*\*\*\*, emëruar me aktin nr. 09, datë 16.03.2001, në pozicionin “Specialist në Sektorin e Planifikim Territorit”.
- ✓ \*\*\*\*\*, i konfirmuar si nëpunës civil në pozicionin “K/inspektor i Tatim Taksave”, me aktin nr. 7, datë 30.10.2006. Në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit, mbante pozicionin e audituesit të brendshëm, sipas Urdhërit nr. 28, datë 10.09.2012. Aktualisht, sipas aktit nr. 16, datë 01.04.2015, mban pozicionin “Inspektor në Sektorin e Prokurimeve”, i cili është i barazvlershëm me pozicionin e inspektorit.

- Në Njësinë Administrative Fushë Krujë:

- ✓ Njësia përgjegjëse e Bashkisë Krujë duhet të ndërpresë marrëdhënien e punës për nëpunësin \*\*\*\*\*, emëruar me aktin nr. 53, datë 15.04.2014, në pozicionin “Inspektor në Drejtorinë e Tatim-Taksave”.

- Në Njësinë Administrative Thumanë:

- ✓ \*\*\*\*\*, emëruar në pozicionin “Përgjegjës i Zyrës së Planifikim Territorit”, me kontratë pune, datë 06.01.2014;
- ✓ \*\*\*\*\*, emëruar në pozicionin “Inspektore e Zyrës së DAMT”, me aktin nr. 62/1, datë 03.09.2013;
- ✓ \*\*\*\*\*, emëruar në pozicionin “Përgjegjës i Zyrës së Shërbimeve”, emëruar me aktin nr.78/1. Datë 01.10.2013.

- Në Njësinë Administrative Bubq:

- ✓ \*\*\*\*\*, emëruar me aktin nr. 12, datë 04.05.2007, në pozicionin “Inspektor në Sektorin e Tatim-Taksave”;
- ✓ \*\*\*\*\*, emëruar me aktin nr. 39, datë 01.08.2011, në pozicionin “Inspektor në Sektorin e Tatim-Taksave”;
- ✓ \*\*\*\*\*, emëruar me aktin nr. 48, datë 30.09.2011, në pozicionin “Inspektor në Sektorin e Shërbimeve”;
- ✓ \*\*\*\*\*, emëruar me aktin nr. 2, datë 01.03.2012, në pozicionin “Specialist Pyjesh”;
- ✓ \*\*\*\*\*, emëruar me aktin nr. 16, datë 01.06.2007, në pozicionin “Specialist Veteriner”.

- Në Njësinë Administrative Cudhi:

- ✓ \*\*\*\*\*, emëruar me aktin nr. 18, datë 16.07.2011, në pozicionin “Specialist i Pyjeve Komunal”;
- ✓ \*\*\*\*\*, emëruar me aktin nr. 15, datë 21.07.2011, në pozicionin “Specialist i Pyjeve Komunal”;
- ✓ \*\*\*\*\*, emëruar me aktin nr. 11, datë 15.07.2011, në pozicionin “Administrator Shoqëror i Ndihmës Ekonomike”;
- ✓ \*\*\*\*\*, emëruar me aktin nr. 17, datë 21.07.2011, në pozicionin “Specialist i Paaftësisë së Kufizuar”;
- ✓ \*\*\*\*\*, emëruar me aktin nr. 14, datë 21.07.2011, në pozicionin “Përgjegjës i Zyrës së Bujqësisë dhe Pyjeve Komunale”.
- ✓ Për nëpunësin \*\*\*\*\*, njësia përgjegjëse duhet të revokojë Urdhrin nr. 184/4, datë 30.04.2014, për deklarimin e statusit të punësimit si nëpunës civil, në pozicionin “Inspektor Finance e Tatimesh”, si dhe të vendoset përfundimi i marrëdhënies së punësimit.

- Në Njësinë Administrative Nikël:

- ✓ \*\*\*\*\*, emëruar me kontratë, datë 16.01.2009, në pozicionin “Inspektor Finance”;
- ✓ \*\*\*\*\*, emëruar me aktin nr. 38, datë 01.12.2003, në pozicionin “Inspektor i Urbanistikës”;
- ✓ \*\*\*\*\*, emëruar me kontratë, datë 03.02.2014, në pozicionin “Inspektor për Arsimin dhe Shëndetësinë”;

- ✓ \*\*\*\*\*; emëruar me kontratë, datë 03.02.2014, në pozicionin “Përgjegjës Shërbimesh”;
- ✓ \*\*\*\*\*; emëruar me kontratë, datë 03.02.2014, në pozicionin “Përgjegjës në Sektorin e Tatim-Taksave”;
- ✓ \*\*\*\*\*; emëruar me kontratë, në datë 03.02.2014, në pozicionin “Specialist i Tatim- Taksave”.

Pozicionet e punës në lidhje me rastet e sipërpërmendura, duhet të konsiderohen pozicione të lira, për t'u plotësuar më tej në përputhje me ligjin nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe në koherencë me strukturën aktuale të Bashkisë Krujë.

4. Njësia përgjegjëse pranë Bashkisë Krujë, të revokojë aktet e emërimit, që kanë dalë në kundërshtim me ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, pa kryer më parë procedurën e konkurrimit, të kërkuar nga nenet 22, e vijues të këtij ligji, si dhe të ndërpresë marrëdhënien e punës, për punonjësit e përmendur më poshtë, të ndarë sipas njësive administrative:

- Në Bashkinë Krujë, për punonjësit:

- ✓ \*\*\*\*\*; emëruar në pozicionin “Inspektore e Tatim-Taksave”, me aktin nr. 17, datë 01.04.2015;
- ✓ \*\*\*\*\*; emëruar në pozicionin “Inspektor i Prokurimeve Publike”, me aktin nr. 16, datë 01.04.2015.

- Në Njësine Administrative Fushë - Krujë, për punonjësit:

- ✓ \*\*\*\*\*; emëruar në pozicionin “Inspektor Personeli”, me aktin nr. 618, datë 06.03.2014;
- ✓ \*\*\*\*\*; emëruar në pozicionin “Inspektore e Buxhetit dhe Aseteve”, me aktin nr. 94, datë 25.06.2015;
- ✓ \*\*\*\*\*; bëhet fjalë për aktin e ngritjes në detyrë, nr. 52, datë 20.03.2014. Pasojat në lidhje me këtë rast, të rregullohen sipas orientimeve në raportin përfundimtar të mbikëqyrjes.

- Në Njësine Administrative Thumanë, për punonjësit:

- ✓ \*\*\*\*\*; emëruar në pozicionin “Inspektore Buxheti”, me aktin nr. 116/1, datë 27.05.2014;
- ✓ \*\*\*\*\*; emëruar në pozicionin “Inspektor i Zyrës së Tatim-Taksave”, me aktin nr. 126, datë 13.10.2014;
- ✓ \*\*\*\*\*; emëruar në pozicionin “Inspektor i Zyrës së Tatim-Taksave”, me aktin nr. 112, datë 06.05.2014;
- ✓ \*\*\*\*\*; emëruar në pozicionin “Juriste”, me aktin nr. 115, datë 13.05.2014;
- ✓ \*\*\*\*\*; emëruar në pozicionin “Administrator i Zyrës së Ndihmës Ekonomike”, me aktin nr. 96/1, datë 04.03.2014;
- ✓ \*\*\*\*\*; emëruar në pozicionin “Përgjegjës i Zyrës së AMMT”, me aktin nr. 117, datë 02.06.2014;

- ✓ \*\*\*\*\*\*, emëruar në pozicionin “*Inspektor i Arsimit dhe Kulturës*”, me aktin nr. 101/1, datë 03.04.2014.
- ✓ Ndërsa në rastin e punonjësit \*\*\*\*\*\*, të revokohet akti nr. 121, datë 16.06.2014, për emërimin në pozicionin “*Përgjegjës i Zyrës së Financës*”, dhe situata e tij të rregullohet sipas detyrave të përcaktuara në pikën 8 të këtij vendimi.
- Në Njësinë Administrative Bubq, për punonjësin:
  - ✓ \*\*\*\*\*\*, emëruar në pozicionin “*Jurist*”, me aktin nr. 1, datë 01.10.2014.
- Në Njësinë Administrative Nikël, për punonjësin:
  - ✓ \*\*\*\*\*\*, emëruar në pozicionin “*Inspektor i Ndhmës Ekonomike*” me aktin nr. 33, datë 01.06.2015.

Pozicionet e punës në lidhje me rastet e sipërpërmendura, duhet të konsiderohen pozicione të lira, për t’u plotësuar më tej në përputhje me ligjin nr.152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, si dhe në koherencë me strukturën aktuale të Bashkisë Krujë.

5. Njësia përgjegjëse pranë Bashkisë Krujë, të revokojë aktin e deklarimit të statusit të punësimit nr. 67, datë 25.05.2014, që ka dalë nga njësia përgjegjëse e Komunës Bubq, për punonjësin \*\*\*\*\*\*, si nëpunës civil në pozicionin e punës “*Inspektor i INUV*”, si akt i dalë në kundërshtim me nenin 2, pika “h”, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, për shkak se këta punonjës, sipas ligjit organik nr. 9780, dt. 16.07.2007, ndryshuar me ligjin nr. 183/2014, datë 24.12.2014, u lejohet të mbajnë armë, e si të tillë, nuk mund të jenë pjesë e shërbimit civil. Marrëdhënia e tij e punësimit të vazhdojë sipas parashikimeve ligjore në fuqi, për këtë kategori punonjësish.

6. Në lidhje me 5 pozicionet e punës në Njësinë Administrative Thumanë, njësia përgjegjëse e Bashkisë Krujë, të veprojë si më poshtë;

- ✓ Për 2 nëpunësit e konstatuar të cilët kanë qenë punonjës ekzistues në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, dhe që kanë qenë të punësuar për një periudhë më tepër se një vit në ato pozicione pune, të bëhet deklarimi i statusit të nëpunësit civil. Bëhet fjalë për punonjësit;
  1. \*\*\*\*\*\*, emëruar në pozicionin “*Jurist*”, me aktin nr. 20, dt.29.07.2011;
  2. \*\*\*\*\*\*, emëruar në pozicionin “*Inspektore Veterinere*”, me aktin nr. 14/1, dt. 04.07.2007.
- ✓ Për 3 nëpunësit e konstatuar të cilët kanë qenë punonjës ekzistues në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, dhe që kanë qenë të punësuar për një periudhë më pak se një vit në ato pozicione pune, të bëhet deklarimi i statusit të nëpunësit civil në periudhë prove. Bëhet fjalë për punonjësit;

- ✓ \*\*\*\*\*, emëruar në pozicionin “Përgjegjëse e Zyrës së Tatim Taksave”, emëruar me aktin nr. 53, datë 02.09.2013;
- ✓ \*\*\*\*\*, emëruar në pozicionin “Administratore e Zyrës së Ndihmës Ekonomike”, emëruar me kontratë në datën 06.01.2014;
- ✓ \*\*\*\*\*, emëruar në pozicionin “Specialist Pyjesh”, me aktin nr. 78, dt.01.10.2013.

7. Njësia përgjegjëse, në lidhje me 2 pozicionet e punës, në Njësinë Administrative Fushë-Krujë, të cilat nuk janë konsideruar si pjesë e shërbimit civil:

- ✓ “Inspektor në Drejtorinë e Financës”, plotësuar nga nëpunësja \*\*\*\*\*, emëruar me aktin nr. 130, datë 04.09.2013;
- ✓ “Inspektor Licencimi në Drejtorinë e Tatim-Taksave”, plotësuar nga nëpunësi \*\*\*\*\*, emëruar me aktin nr. 131, datë 04.09.2013,

duhet t’i vlerësojë si pozicione pune pjesë e shërbimit civil, pasi kanë elementë të realizimit të funksioneve publike dhe kanë karakteristikat dalluese të shërbimit civil.

Punonjësit e mësipërm, janë punësuar me akte emërimi të përkohshme, përpara hyrjes në fuqi të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, për më pak se një vit kohë, prandaj në bazë të nenit 67, pika 4, të ligjit nr. 152/2013 ”Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, ata duhet të përfitojnë statusin e nëpunësit civil në periudhë prove, në pozicionet që kanë pasur në momentin e fillimit të efekteve të ligjit. Njësia përgjegjëse duhet të kujdeset që ata të kryejnë detyrimet e nenit 24 të ligjit aktual për nëpunësin civil.

8. Njësia përgjegjëse pranë Bashkisë Krujë;

- ✓ Të ndryshojë aktin e deklarimit të statusit të punësimit për nëpunësin \*\*\*\*\*, emëruar me aktin nr. 28, datë 01.04.2013, në pozicionin “Inspektor i Bujqësisë” pranë Komunës Nikël, duke nxjerë aktin e deklarimit të statusit të punësimit si “nëpunës civil në periudhë prove”.
- ✓ Të ndryshojë aktin e deklarimit të statusit të punësimit për nëpunësen \*\*\*\*\*, emëruar në datë 01.07.2013, në pozicionin “Përgjegjëse e Urbanistikës” pranë Komunës Bubq, duke nxjerë aktin e deklarimit të statusit të punësimit si “nëpunës civil në periudhë prove”.
- ✓ Për punonjësin \*\*\*\*\* të verifikohet niveli arsimor dhe të deklarohet statusi i punësimit në pozicionin e punës që ka patur në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013 ”Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

9. Njësia përgjegjëse, në lidhje me 3 pozicionet e plotësuara nëpërmjet konkurrimit, në Bashkinë Krujë, të vijojë procedurat e kërkuara nga ligji, për të përfunduar procesin e periudhës së provës, të cilat në këtë rast janë, vlerësimi i punës dhe trajnimi i detyrueshëm në Shkollën e Administratës Publike (ASP).

Pas realizimit të këtyre procedurave, duhet të vijojë procesi, sipas kërkesave të nenit 24, të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar.

Në këtë rast, bëhet fjalë për punonjësit:

1. \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës, "Inspektore në Sektorin Ekonomik", (emëruar në shërbimin civil, në kategorinë ekzekutive, me aktin nr. 29 prot., dt.04.09.2014);
  2. \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës, "Inspektore e Marrëdhënieve me Publikun në Sektorin Juridik", (emëruar në shërbimin civil, në kategorinë ekzekutive, me aktin nr. 43 prot., dt. 03.10.2014).
  3. \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës, "Inspektor i Prokurimeve Publike", (emëruar në shërbimin civil, në kategorinë ekzekutive me aktin nr. 21 prot., dt. 04.06.2014).
10. Njësia përgjegjëse pranë Bashkisë Krujë, për të rregulluar paligjshmërinë e konstatuar në Komunën Thumanë, në kushtet kur njësia përgjegjëse e këtij subjekti, nuk kishte kryer asnjë veprim për të filluar zbatimin e ligjit për nëpunësin civil, në lidhje me deklarinimin e statusit të punësimit, të veprorë sipas këtij rendi:
- *së pari*, të plotësojë dosjet individuale me të gjitha të dhënat sipas kërkesave të ligjit, me qëllim që të materializohet procesi i verifikimit të plotësimit të kushteve ligjore të parashikuara në nenin 67, të ligjit nr.152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar,
  - *së dyti*, të përfundojë procesin e deklarinimit të statusit të punësimit për secilin prej punonjësve të punësuar në pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil, sipas kriterëve dhe kushteve të përcaktuara në nenin 67, të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar.
11. Njësia përgjegjëse pranë Bashkisë Krujë, të hartojë menjëherë përshtimet e punës për pozicionet që përfshihen në shërbimin civil, sipas formatit të miratuar, në Vendimin nr. 142, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për përshtimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura" dhe lidhjes 4, bashkëlidhur këtij vendimi, si dhe në Udhëzimin nr. 2, datë 07.04.2014, të Departamentit të Administratës Publike, "Për hartimin e përshtimit të pozicioneve të punës në shërbimin civil".
12. Të plotësohen dosjet e personelit, sipas konstatimeve të evidentuara në aneksin nr. 2 të Raportit Përfundimtar "Respektimi i kërkesave të përgjithshme sipas nenit 21 të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, për punonjësit që janë të emëruar në pozicione pune pjesë e shërbimit civil në datën 26.02.2014, si dhe të punonjësve që janë aktualisht në pozicione pune pjesë e shërbimit civil".
13. Në lidhje me informacionet e ardhura në drejtim të Komisionerit të cilat janë trajtuar gjatë mbikëqyrjes, njësia përgjegjëse duhet të veprorë si më poshtë:
- Për nëpunësen \*\*\*\*\*, në kushtet kur nuk janë zhvilluar procedurat ligjore në një rast ristrukturimi, të revokohet akti nr. 1947/2, datë 28.09.2015, i Kryetarit të Bashkisë Krujë, për ndërprerjen e marrëdhënies së punës dhe të fillojë nga e para,



procedura e parashikuar nga neni 50, i ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore që e rregullojnë procesin.

- Për nëpunësin \*\*\*\*\*\*, njësia përgjegjëse, duhet të veprojë sipas detyrave që janë përcaktuar në pikën 3, Njësia Administrative Cudhi, të këtij vendimi dhe të orientimeve në raportin përfundimtar.

14. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat **60** ditë nga marrja dijani për këtë vendim. Njësia përgjegjëse, duhet të zbatojë këtë vendim duke u bazuar në detyrat dhe orientimet e materializuara në përmbajtjen e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes.

Me kalimin e afatit procedural të lënë për zbatimin e rekomandimeve në vendimin e mësipërm, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, bazuar në nenin 14, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në ligjin nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” dhe në Rregulloren “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, vendosi kryerjen e mbikëqyrjes në vazhdim, për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në Vendimin nr.30, datë 31.03.2016.

Me Vendimin nr.63, datë 31.05.2016, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, u ngrit grupi i punës, i cili u paraqit në subjektin, Bashkia Krujë në datën 06.06.2016 dhe i kërkoi personit përgjegjës, nëpunësit \*\*\*\*\*\*, dosjet e personelit dhe dokumentacionin shkresor të dalë në zbatim të rekomandimeve të Komisionerit.

Në përfundim të verifikimit, grupi i punës pas shqyrtimit të akteve të nxjerra nga njësia përgjegjëse e Bashkisë Krujë konstatoi se :

1. Në zbatim të pikës 2 të dispozitivit të vendimit, njësia përgjegjëse ka bërë ndarjen e pozicioneve të punës që janë në shërbimin civil, nga funksionet ndihmëse administrative, sipas parashikimeve të nenit 4 të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar. Po kështu në zbatim të nenit 2 dhe 19, të ligjit të mësipërm, në Vendimin nr.21, dt.31.05.2016, “Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Krujë për vitin 2016”, është bërë emërtesa dhe klasifikimi sipas kategorive, klasave dhe natyrës së pozicionit. Klasifikimi i pozicionit të punës është bazuar në përshkrimin e punës të çdo pozicioni.
2. Lidhur me punonjësit që nuk përmbushnin kriterin e nivelit arsimor për të qenë nëpunës civilë, për të cilët Komisioneri në pikën 3 të vendimit paralajmërues ka kërkuar nga njësia përgjegjëse që të përfundojë marrëdhëniet e punësimit, rezultoi se:

✓ Në Bashkinë Krujë

- Me Vendimin nr.66, dt.01.10.2015, punonjësja \*\*\*\*\*\* me detyrë “Inspektore në Sektorin Ekonomik”, është larguar nga detyra dhe i është ndërprerë marrëdhënia e punësimit, bazuar në nenin 65/c të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, për shkak të plotësimit të moshës për pensionin e plotë të pleqërisë.

- Me Vendimin nr.2491, dt.23.06.2016, punonjësi \*\*\*\*\* me detyrë “*Inspektor në Sektorin e Tatim-Taksave*”, është larguar nga detyra dhe i është ndërprerë marrëdhënia e punësimit, bazuar në Urdhrin nr.71, dt.15.09.2015 të Kryetarit të Bashkisë Krujë “*Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Krujë për periudhën e ristrukturimit*” dhe për shkak të mosplotësimit të kriterit arsimor.
- Me Vendimin nr.2490, dt.23.06.2016, punonjësi \*\*\*\*\* me detyrë “*Inspektor në Sektorin e Tatim-Taksave*”, është larguar nga detyra dhe i është ndërprerë marrëdhënia e punësimit, bazuar në Urdhrin nr.71, dt.15.09.2015 të Kryetarit të Bashkisë Krujë “*Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Krujë për periudhën e ristrukturimit*”, si dhe për shkak të mosplotësimit të kriterit arsimor.
- Në rastet e punonjësve, si më poshtë:
  1. \*\*\*\*\* , me detyrë “*Inspektor në Sektorin e Tatim-Taksave*”, i cili me Urdhrin nr.182, dt. 5.5.2016, është larguar nga detyra dhe i është ndërprerë marrëdhënia e punësimit, bazuar në Urdhrin nr.6, dt.29.01.2016, të Kryetarit të Bashkisë Krujë “*Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Krujë për vitin 2016*” dhe nenit 143/1 dhe 145 të ligjit nr. 7961, dt. 12.7.1995 “*Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë*”, i ndryshuar.
  2. \*\*\*\*\* , me detyrë “*Inspektor në Sektorin e Arsimit dhe Kulturës*”, të cilit me aktin administrativ nr. 192, datë 31.12.2015, i është ndërprerë marrëdhënia e punës, bazuar në Urdhrin nr.71, datë 15.09.2015, të Kryetarit të Bashkisë Krujë, “*Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Krujë për periudhën e ristrukturimit*”.
  3. \*\*\*\*\* , me detyrë “*Specialist në Sektorin e Planifikimit të Territorit*”, të cilit me aktin administrativ nr.2333, datë 14.06.2016, i është ndërprerë marrëdhënia e punës, bazuar në Urdhrin nr.71, datë 15.09.2015, të Kryetarit të Bashkisë Krujë, “*Për miratimin e strukturës organizative të Bashkiaë Krujë për periudhën e ristrukturimit*”.
  4. \*\*\*\*\* , me detyrë “*Inspektor në Sektorin e Tatim-Taksave*”, i cili me Vendimin nr.6, dt. 1.3.2016, është larguar nga detyra dhe i është ndërprerë marrëdhënia e punësimit, bazuar në Vendimin nr.6, dt.29.01.2016, të Kryetarit të Bashkisë Krujë, “*Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Krujë për vitin 2016*” dhe nenit 143/1 dhe 145 të ligjit nr. 7961, dt. 12.7.1995 “*Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë*”, i ndryshuar (punonjësi është diplomuar në Fakultetin e Ekonomisë në Universitetin e Tiranës në datë 06.05.2014, pas hyrjes në fuqi të ligjit për shërbimin civil, dt.26.02.2014).

Pavarësisht faktit që marrëdhënia e tyre e punësimit ka përfunduar tashmë, baza ligjore (ligji nr.7961, dt.12.07.1995 “*Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë*”, i ndryshuar) dhe shkakut i përfundimit të kësaj marrëdhënieje (ristrukturimi) është i gabuar. Në aktin e lirimit, në bazën ligjore të tij, duhej cituar shkronja “e” e nenit 21 të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, ku parashikohet shprehimisht se një kandidat për nëpunës civil duhet të plotësojë kërkesat e posaçme për nivelin e arsimit që në këtë rast është arsim i lartë.

Në kushtet kur punonjësit nuk i plotësonin kriteret për të qenë nëpunës civilë sipas ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, njësia e burimeve njerëzore, duhej të vendoste përfundimin e marrëdhënies së punësimit për këta punonjës, veprim i parashikuar në pikën 6 të Vendimit nr. 116, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave “Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”.

Sa më sipër, arrihet në përfundimin se aktet për përfundimin e marrëdhënies së punësimit të punonjësve të mësipërm kanë dalë në kundërshtim me shkronjën”d” të nenit 109 të ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

Për këtë arsye, njësia e burimeve njerëzore të institucionit duhet të drejtojë procesin për shfuqizimin e pjesëshëm të këtyre akteve, në të cilat duhet të ndryshohet shkaku ligjor nga ana e Kryetarit të Bashkisë Krujë, veprim i cili do të ketë pasoja vetëm për të ardhmen sipas përcaktimeve të nenit 113 të ligjit të mësipërm. Aktet e ndryshuara duhet të bëhen pjesë e dosjes së personelit për këta punonjës.

- Me Vendimin nr.2489, dt.23.06.2015, punonjësja \*\*\*\*\* me detyrë “Inspektor në Sektorin e Shërbimit Social”, është larguar nga detyra dhe i është ndërprerë marrëdhënia e punësimit, bazuar në Urdhrin nr.71, dt.15.09.2015 të Kryetarit të Bashkisë Krujë “Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Krujë për periudhën e ristrukturimit”, si dhe për shkak të mosplotësimit të kriterit arsimor sipas rekomandimit të Vendimit nr.116, datë 31.03.2016, të Komisionerit.
- Nga përmbajtja e Urdhrit nr.86, dt.01.03.2016, rezulton se punonjësja \*\*\*\*\* është emëruar në detyrën “Punonjëse për Administrimin e Dosjeve të Ndihmës Ekonomike”. Nga verifikimi i strukturës organizative të Bashkisë Krujë, miratuar me Vendimin nr.21, dt.31.05.2016, pozicioni i punonjësës \*\*\*\*\* nuk përfshihet në fushën e veprimit të ligjit për shërbimin civil, çka presupozon lirim të saj nga pozicioni që mbante në shërbimin civil si “Inspektore në Sektorin e Shërbimit Social”.

✓ Në Njësinë Administrative Fushë-Krujë:

- Me Urdhrin nr.193, dt.07.01.2016, të Kryetarit të Bashkisë, punonjësi \*\*\*\*\* me detyrë “Inspektor në Drejtorinë e Tatim-Taksave”, është larguar nga ky pozicion me kërkesën e tij për dorëheqje nr.36, dt.06.01.2016, përpara se të dalë Vendimi nr.30, dt.31.03.2016 i Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.

✓ Në Njësinë Administrative Thumanë:

- Me Vendimin nr.53, dt.1.9.2015 të Kryetarit të Bashkisë, punonjësi \*\*\*\*\* me detyrë “Përgjegjës i Zyrës së Planifikimit të Territorit”, është larguar nga ky pozicion me kërkesën e tij për dorëheqje nr.1675, dt.01.09.2015, përpara daljes së vendimit objekt verifikimi.
- Me Urdhrin nr.147, dt.02.12.2015, të Kryetarit të Bashkisë, punonjësja \*\*\*\*\* me detyrë “Inspektore e Drejtorisë së Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës”, është larguar

nga ky pozicion dhe i është ndërprerë marrëdhënia e punës, bazuar në Urdhrin nr.71, dt.15.09.2015, të Kryetarit të Bashkisë Krujë “Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Krujë për periudhën e ristrukturimit” dhe nenit 143/1 dhe 145 të ligjit nr. 7961, dt. 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, përpara se të dalë vendimi i Komisionerit.

Për këtë arsye, njësia e burimeve njerëzore të institucionit duhet të drejtojë procesin për shfuqizimin e pjesshëm të aktit nr.147, datë 02.12.2015 nga Kryetari i Bashkisë, në të cilin duhet të ndryshohet shkaku ligjor i ndërprerjes së marrëdhënies së punësimit, që është mosplotësimi i kriterit të nivelit arsimor të parashikuar në shkronjën “e” të nenit 21 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, ku përcaktohet shprehimisht se një kandidat për nëpunës civil duhet të plotësojë kërkesat e posaçme për nivelin e arsimit (*punonjësja është me arsim të mesëm*).

- Me Vendimin nr.47, dt.01.09.2015, të Kryetarit të Bashkisë, punonjësi \*\*\*\*\* me detyrë “Përgjegjës i Zyrës së Shërbimeve”, është larguar nga ky pozicion me kërkesën e tij nr.1672, dt.01.09.2015, përpara se të dalë vendimi i Komisionerit.

✓ Në Njësinë Administrative Bubq:

- Në rastet e punonjësve, si më poshtë:

1. \*\*\*\*\* me detyrë “Inspektor në Sektorin e Tatim Taksave”, i cili me Urdhrin nr.3080/14, dt. 31.12.2015, të Kryetarit të Bashkisë, është larguar nga detyra dhe i është ndërprerë marrëdhënia e punësimit, bazuar në Urdhrin nr.71, dt.15.9.2015 të Kryetarit të Bashkisë Krujë “Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Krujë për periudhën e ristrukturimit” dhe nenit 143/1 dhe 145 të ligjit nr. 7961, dt. 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.
2. \*\*\*\*\* me detyrë “Inspektor në Sektorin e Shërbimeve”, i cili me Urdhrin nr.147, datë 02.12.2015, të Kryetarit të Bashkisë, është larguar nga ky pozicion dhe i është ndërprerë marrëdhënia e punës, bazuar në Urdhrin nr.71, dt.15.9.2015 të Kryetarit të Bashkisë Krujë “Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Krujë për periudhën e ristrukturimit” dhe nenit 143/1 dhe 145 të ligjit nr. 7961, dt. 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, përpara se të dalë vendimi i Komisionerit.

Pavarësisht faktit që marrëdhënia e tyre e punësimit ka përfunduar tashmë, baza ligjore (ligji nr.7961, dt.12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar) dhe shkaku i përfundimit të kësaj marrëdhënieje (ristrukturimi) është i gabuar. Në aktin e lirit, në bazën ligjore të tij, duhej cituar shkronja “e” e nenit 21 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, ku parashikohet shprehimisht se një kandidat për nëpunës civil duhet të plotësojë kërkesat e posaçme për nivelin e arsimit që në këtë rast është arsim i lartë.

Në kushtet kur punonjësit nuk i plotësonin kriteret për të qenë nëpunës civilë sipas ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, njësia e burimeve njerëzore, duhej të vendoste përfundimin e marrëdhënies së punësimit për këta punonjës, veprim i

parashikuar në pikën 6 të Vendimit nr. 116, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave “Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”.

Sa më sipër, arrihet në përfundimin se aktet për përfundimin e marrëdhënies së punësimit të punonjësve të mësipërm kanë dalë në kundërshtim me shkronjën”d” të nenit 109 të ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

Për këtë arsye, njësia e burimeve njerëzore të institucionit duhet të drejtojë procesin për shfuqizimin e pjesshëm të këtyre akteve, në të cilat duhet të ndryshohet shkaku ligjor nga ana e Kryetarit të Bashkisë Krujë, veprim i cili do të ketë pasoja vetëm për të ardhmen sipas përcaktimeve të nenit 113 të ligjit të mësipërm. Aktet e ndryshuara duhet të bëhen pjesë e dosjes së personelit për këta punonjës.

- Nga përmbajtja e Urdhrit nr.86, dt.01.03.2016, të Kryetarit të Bashkisë Krujë rezulton se punonjësi \*\*\*\*\* është emëruar në detyrën “Punonjës për Pyjet ” në Njësinë Administrative Bubq. Nga verifikimi i strukturës organizative të Bashkisë Krujë, miratuar me Vendimin nr.06, dt.29.01.2016, ky pozicion nuk përfshihet në fushën e veprimit të ligjit për shërbimin civil, çka presupozon lirim të tij nga pozicioni që mbante në shërbimin civil si, “Specialist Pyjesh”.
- Nga përmbajtja e Urdhrit nr.91, dt.28.09.2015, të Kryetarit të Bashkisë Krujë, punonjësi \*\*\*\*\* është emëruar në detyrën “Punonjës Ujësjellësi ” në Njësinë Administrative Bubq. Nga verifikimi i strukturës organizative të Bashkisë Krujë, miratuar me Vendimin nr.71, dt.15.09.2016, pozicioni i punonjësit të mësipërm nuk përfshihet në fushën e veprimit të ligjit për shërbimin civil, çka presupozon lirim të tij nga pozicioni që mbante në shërbimin civil si, “Inspektor në Sektorin e Tatim-Taksave”. Ky veprim administrativ është bërë përpara se të dalë vendimi i Komisionerit.
- Nga përmbajtja e Urdhrit nr.803 Prot., dt.01.03.2016, të Kryetarit të Bashkisë Krujë, punonjësi \*\*\*\*\* është emëruar në detyrën “Punonjës për Blektorinë” në Njësinë Administrative Bubq. Nga verifikimi i strukturës organizative të Bashkisë Krujë, miratuar me Vendimin nr.06, dt.29.01.2016, pozicioni i punonjësit të mësipërm nuk përfshihet në fushën e veprimit të ligjit për shërbimin civil, çka presupozon lirim të tij nga pozicioni që mbante në shërbimin civil si, “Specialist Veteriner”.

✓ Në Njësinë Administrative Cudhi:

➤ Në rastet e punonjësve, si më poshtë:

1. \*\*\*\*\* me detyrë “Specialist i Pyjeve”, i cili me Urdhrit nr.192, dt.31.12.2015, të Kryetarit të Bashkisë Krujë, është larguar nga ky pozicion dhe i është ndërprerë marrëdhënia e punës, bazuar në Urdhrit nr.71, dt.15.9.2015 të Kryetarit të Bashkisë Krujë “Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Krujë për periudhën e

*ristrukturimit*” dhe nenit 143/1 dhe 145 të ligjit nr. 7961, dt.12.7.1995 “*Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë*”, i ndryshuar, përpara se të dalë vendimi i Komisionerit.

2. \*\*\*\*\* me detyrë “*Specialist i Pyjeve*”, i cili me Urdhrin nr.115, dt.20.10.2015, të Kryetarit të Bashkisë, punonjësi \*\*\*\*\* me detyrë “*Specialist i Pyjeve*”, është larguar nga ky pozicion dhe i është ndërprerë marrëdhënia e punës, bazuar në Urdhrin nr.71, dt.15.9.2015 të Kryetarit të Bashkisë Krujë “*Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Krujë për periudhën e ristrukturimit*” dhe nenit 143/1 dhe 145 të ligjit nr. 7961, dt.12.7.1995 “*Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë*”, i ndryshuar”, përpara se të dalë vendimi i Komisionerit.
3. \*\*\*\*\* me detyrë “*Specialist i Paaftësisë së Kufizuar*”, i cili me Urdhrin nr.147, dt.02.12.2015, të Kryetarit të Bashkisë është larguar nga ky pozicion pune dhe i është ndërprerë marrëdhënia e punës, bazuar në Urdhrin nr.71, dt.15.9.2015 të Kryetarit të Bashkisë Krujë “*Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Krujë për periudhën e ristrukturimit*” dhe nenit 143/1 dhe 145 të ligjit nr. 7961, dt.12.7.1995 “*Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë*”, i ndryshuar”, përpara se të dalë vendimi i Komisionerit.

Pavarësisht faktit që marrëdhënia e tyre e punësimit ka përfunduar tashmë, baza ligjore (ligji nr.7961, dt.12.07.1995 “*Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë*”, i ndryshuar) dhe shkaku i përfundimit të kësaj marrëdhënieje (ristrukturimi) është i gabuar. Në aktin e lirimt, në bazën ligjore të tij, duhej cituar shkronja “e” e nenit 21 të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, ku parashikohet shprehimisht se një kandidat për nëpunës civil duhet të plotësojë kërkesat e posaçme për nivelin e arsimit që në këtë rast është arsim i lartë.

Në kushtet kur punonjësit nuk i plotësonin kriteret për të qenë nëpunës civilë sipas ligjit nr.152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, njësia e burimeve njerëzore, duhej të vendoste përfundimin e marrëdhënies së punësimit për këta punonjës, veprim i parashikuar në pikën 6 të Vendimit nr. 116, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave “*Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”*”.

Sa më sipër, arrihet në përfundimin se aktet për përfundimin e marrëdhënies së punësimit të punonjësve të mësipërm kanë dalë në kundërshtim me shkronjën”d” të nenit 109 të ligjit nr.44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*”.

Për këtë arsye, njësia e burimeve njerëzore të institucionit duhet të drejtojë procesin për shfuqizimin e pjesshëm të këtyre akteve, në të cilat duhet të ndryshohet shkaku ligjor nga ana e Kryetarit të Bashkisë Krujë, veprim i cili do të ketë pasoja vetëm për të ardhmen sipas përcaktimeve të nenit 113 të ligjit të mësipërm. Aktet e ndryshuara duhet të bëhen pjesë e dosjes së personelit për këta punonjës.

- Nga përmbajtja e Urdhrit nr.86, datë 01.03.2016, të Kryetarit të Bahkisë Krujë, punonjësi Saba Sejдини është emëruar në detyrën “*Punonjës personeli, protokolli, arkivi dhe i ndihmës ekonomike*” në Njësinë Administrative Cudhi. Nga verifikimi i

strukturës organizative të Bashkisë Krujë, miratuar me Vendimin nr.06, dt.29.01.2016, pozicioni i punonjësit të mësipërm nuk përfshihet në fushën e veprimit të ligjit për shërbimin civil, çka presupozon lirim të tij nga pozicioni që mbante në shërbimin civil si, “Administrator Shoqëror i Ndhmës Ekonomike”.

- Me Vendimin nr.67, dt.01.10.2015, punonjësi \*\*\*\*\* me detyrë “Përgjegjës i Zyrës së Bujqësisë”, është larguar nga detyra dhe i është ndërprerë marrëdhënia e punësimit, bazuar në nenin 65/c të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar (Plotësimi i moshës së pensionit), përpara daljes së vendimit të Komisionerit. Të tërhiqet vëmendja e njësisë përgjegjëse të ketë kujdes në të ardhmen për raste të ngjashme, sepse referenca ligjore e këtij akti është e gabuar, për shkak se nëpunësi nuk plotësonte kriteret për të qenë nëpunës civil e për rrjedhojë kjo marrëdhënie pune nuk rregullohej nga ligji për shërbimin civil.
- Me Urdhrin nr.116, dt. 20.10.2015, punonjësi \*\*\*\*\* me detyrë “Inspektor Finance e Tatimesh” është larguar nga detyra dhe i është ndërprerë marrëdhënia e punësimit, bazuar në Urdhrin nr.71, dt.15.9.2015 të Kryetarit të Bashkisë Krujë “Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Krujë për periudhën e ristrukturimit”. Me Urdhrin nr.116, dt.20.10.2015, të Kryetarit të Bashkisë, punonjësi nuk ka qenë dakord dhe ka bërë ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Nga dokumentacioni i administruar në dosje, u konstatua fakti, se kjo mosmarrëveshje administrative ishte shqyrtuar nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë dhe kjo e fundit me Vendimin e datës 25.01.2016 ka vendosur rrëzimin e padisë së ngritur nga paditësi, \*\*\*\*\*.  
Punonjësi \*\*\*\*\* me kërkesën ankimore nr.841 Prot., dt.03.03.2016, ka kundërshtuar vendimin e mësipërm përpara Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

✓ Në Njësinë Administrative Nikël:

➤ Në rastet e punonjësve, si më poshtë:

- 1.Me Urdhrin nr.192, dt.31.12.2015, të Kryetarit të Bashkisë, punonjësi Ramazan Verjoni me detyrë “Inspektor Finance”, është larguar nga ky pozicion dhe i është ndërprerë marrëdhënia e punës, bazuar në Urdhrin nr.71, dt.15.9.2015 të Kryetarit të Bashkisë Krujë “Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Krujë për periudhën e ristrukturimit” dhe nenit 143/1 dhe 145 të ligjit nr. 7961, dt.12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, përpara se të dalë vendimi i Komisionerit.
2. Me Urdhrin nr.147, dt.02.12.2015, të Kryetarit të Bashkisë, punonjësi Servet Çangu me detyrë “Përgjegjës Shërbimesh”, është larguar nga ky pozicion dhe i është ndërprerë marrëdhënia e punës, bazuar në Urdhrin nr.71, dt.15.9.2015 të Kryetarit të Bashkisë Krujë “Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Krujë për periudhën e ristrukturimit” dhe nenit 143/1 dhe 145 të ligjit nr. 7961, dt.12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, përpara se të dalë vendimi i Komisionerit.

Pavarësisht faktit që marrëdhënia e tyre e punësimit ka përfunduar tashmë, baza ligjore (ligji nr.7961, dt.12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar) dhe shkak i

përfundimit të kësaj marrëdhënieje (ristrukturimi) është i gabuar. Në aktin e lirim, në bazën ligjore të tij, duhej cituar shkronja “e” e nenit 21 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, ku parashikohet shprehimisht se një kandidat për nëpunës civil duhet të plotësojë kërkesat e posaçme për nivelin e arsimit që në këtë rast është arsim i lartë.

Në kushtet kur punonjësit nuk i plotësonin kriteret për të qenë nëpunës civilë sipas ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, njësia e burimeve njerëzore, duhej të vendoste përfundimin e marrëdhënies së punësimit për këta punonjës, veprim i parashikuar në pikën 6 të Vendimit nr. 116, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave “Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”.

Sa më sipër, arrihet në përfundimin se aktet për përfundimin e marrëdhënies së punësimit të punonjësve të mësipërm kanë dalë në kundërshtim me shkronjën “d” të nenit 109 të ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

Për këtë arsye, njësia e burimeve njerëzore të institucionit duhet të drejtojë procesin për shfuqizimin e pjesshëm të këtyre akteve, në të cilat duhet të ndryshohet shkaku ligjor nga ana e Kryetarit të Bashkisë Krujë, veprim i cili do të ketë pasoja vetëm për të ardhmen sipas përcaktimeve të nenit 113 të ligjit të mësipërm. Aktet e ndryshuara duhet të bëhen pjesë e dosjes së personelit për këta punonjës.

- Nga përmbajtja e Urdhrit nr.92, dt.28.09.2015, të Kryetarit të Bashkisë Krujë, punonjësi \*\*\*\*\* është emëruar në detyrën “Punëtor Mirëmbajtje” në Njësinë Administrative Nikël. Nga verifikimi i strukturës organizative të Bashkisë Krujë, miratuar me Vendimin nr.06, dt.29.01.2016, pozicioni i punonjësit të mësipërm nuk përfshihet në fushën e veprimit të ligjit për shërbimin civil, çka presupozon lirin e tij nga pozicioni që mbante në shërbimin civil si, “Inspektor i Urbanistikës”.
- Nga përmbajtja e Urdhrit nr.92, dt.28.09.2015, të Kryetarit të Bashkisë Krujë, punonjësi \*\*\*\*\* është emëruar në detyrën “Punëtor Mirëmbajtje” në Njësinë Administrative Nikël. Nga verifikimi i strukturës organizative të Bashkisë Krujë, miratuar me Vendimin nr.06, dt.29.01.2016, pozicioni i punonjësit të mësipërm nuk përfshihet në fushën e veprimit të ligjit për shërbimin civil, çka presupozon lirin e tij nga pozicioni që mbante në shërbimin civil si, “Inspektor për Arsimin dhe Shëndetësinë”.
- Për punonjësin \*\*\*\*\* , me detyrë “Specialist tatim-taksash”, shkak për përfundimin e marrëdhënies së punës në shërbimin civil, me aktin nr.140, dt.01.12.2015, është bërë plotësimi i moshës për pensionin e plotë të pleqërisë, bazuar në ligjin nr.7703, datë 11.05.1993 ”Për sigurimet shoqërore”, i ndryshuar. Akti administrativ i cituar më sipër ka dalë përpara se të dalë vendimi i Komisionerit për përfundimin e mbikëqyrjes.
- Me Njoftimin nr.2086, dt.31.05.2016, të titullarit të Njesisë Përgjegjëse të Bashkisë Krujë, punonjëses \*\*\*\*\* me detyrë “Përgjegjëse në Sektorin e Tatim-Taksave”, në Njësinë Administrative Nikël, i është ndërprerë marrëdhënia e punës.



Nga përmbajtja e njoftimit, shkak për ndërprerjen e marrëdhënies së punës është zbatimi i Vendimit nr.30, dt.31.3.2016 të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.

Njësia përgjegjëse e Bashkisë Krujë, me shkresën nr.2566, dt.20.11.2015, ka dërguar shkresë në institucionin, Shërbimi Kombëtar i Punësimit, në lidhje me shpalljen e pozicioneve të lira të punës.

3.Në pikën 4 të dispozitivit të vendimit, Komisioneri ka këkuar nga njësia përgjegjëse pranë Bashkisë Krujë, të revokojë aktet e emërimit që kanë dalë në kundërshtim me ligjin, pa kryer më parë procedurën e konkurrimit. Situata në lidhje me zbatimin e kësaj pike të vendimit rezulton si më poshtë:

✓ Në Bashkinë Krujë:

- Nga përmbajtja e njoftimit nr.1966/10 Prot., dt.21.09.2015, të Kryetarit të Bashkisë, arrihet në përfundimin se punonjësi Klajdi Rroshi me detyrë “*Inspektor i Prokurimeve Publike*”, është larguar nga ky pozicion dhe i është ndërprerë marrëdhënia e punës, bazuar në Urdhrin nr.71, dt.15.9.2015 të Kryetarit të Bashkisë Krujë “*Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Krujë për periudhën e ristrukturimit*” dhe nenit 143/1 dhe 145 të ligjit nr. 7961, dt. 12.7.1995 “*Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë*”, i ndryshuar. Akti administrativ i cituar më sipër ka dalë përpara se të dalë vendimi i Komisionerit për përfundimin e mbikëqyrjes.

Pavarësisht faktit që kjo marrëdhënie pune është ndërprerë tashmë, duke qenë se jemi përpara një marrëdhënie pune administrative (*pozicioni i punës i punonjësit i përket shërbimit civil*), që rregullohet nga ligji për shërbimin civil, si bazë ligjore për ndërprerjen e saj duhej cituar neni 22 i ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, dhe dispozita përkatëse e Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë.

Sa më sipër, arrihet në përfundimin se akti për përfundimin e marrëdhënies së punësimit të punonjësit të mësipërm ka dalë në kundërshtim me shkronjën”d” të nenit 109 të ligjit nr.44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*”.

Për këtë arsye, njësia e burimeve njerëzore të institucionit duhet të drejtojë procesin për shfuqizimin e pjesshëm të këtij akti, në të cilin duhet të ndryshohet shkaku ligjor nga ana e Kryetarit të Bashkisë Krujë, veprim i cili do të ketë pasoja vetëm për të ardhmen sipas përcaktimeve të nenit 113 të ligjit nr. 44/2015, “*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*”. Akti i ndryshuar duhet të bëhet pjesë e dosjes së personelit për këtë punonjës.

- Me Urdhrin nr.28, dt.1.2.2016, të Kryetarit të Bashkisë, punonjësja \*\*\*\*\* me detyrë “*Inspektore e Tatim-Taksave*”, është larguar nga ky pozicion me kërkesën e saj për dorëheqje nr.344, dt.1.2.2016. Akti administrativ i cituar më sipër ka dalë përpara se të dalë vendimi i Komisionerit për përfundimin e mbikëqyrjes.

✓ Në Njësinë Administrative Fushë-Krujë:

➤ Në rastet e punonjësve, si më poshtë:

1. Nga përmbajtja e Urdhrit nr.112, dt.16.10.2015, të Kryetarit të Bashkisë, arrihet në përfundimin se punonjësi \*\*\*\*\* me detyrë “*Specialist personeli*”, është larguar nga ky pozicion dhe i është ndërprerë marrëdhënia e punës, bazuar në Urdhrin nr.71, dt.15.9.2015 të Kryetarit të Bashkisë Krujë “*Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Krujë për periudhën e ristrukturimit*” dhe nenit 143/1 dhe 145 të ligjit nr. 7961, dt. 12.7.1995 “*Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë*”, i ndryshuar.
2. Nga përmbajtja e njoftimit nr.328 Prot., dt.29.01.2016, të Kryetarit të Bashkisë, arrihet në përfundimin se punonjëses \*\*\*\*\* i është ndërprerë marrëdhënia e punës, bazuar në Urdhrin nr.71, dt.15.9.2015 të Kryetarit të Bashkisë Krujë “*Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Krujë për periudhën e ristrukturimit*” dhe nenit 143/1 dhe 145 të ligjit nr. 7961, dt. 12.7.1995 “*Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë*”, i ndryshuar.

Pavarësisht faktit që këto marrëdhënie pune janë ndërprerë tashmë, duke qenë se kemi të bëjmë me marrëdhënie pune administrative (*pozicioni i punës i punonjësit i përket shërbimit civil*), që rregullohen nga ligji për shërbimin civil, si bazë ligjore për ndërprerjen e tyre duhej cituar neni 22 i ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, dhe dispozita përkatëse e Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë.

Sa më sipër, arrihet në përfundimin se aktet për përfundimin e marrëdhënies së punësimit të punonjësve të mësipërm kanë dalë në kundërshtim me shkronjën”d” të nenit 109 të ligjit nr.44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*”.

Për këtë arsye, njësia e burimeve njerëzore të institucionit duhet të drejtojë procesin për shfuqizimin e pjesshëm të këtyre akteve, në të cilat duhet të ndryshohet shkaku ligjor nga ana e Kryetarit të Bashkisë Krujë, veprim i cili do të ketë pasoja vetëm për të ardhmen sipas përcaktimeve të nenit 113 të ligjit nr. 44/2015, “*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*”. Aktet e ndryshuara duhet të bëhen pjesë e dosjes së personelit për këta punonjës.

- Rasti i punonjëses \*\*\*\*\* rezulton si vijon: Fillimi marrëdhënies së punës me aktin administrativ nr.94, dt.25.06.2015 për punonjësen \*\*\*\*\* është bërë në kundërshtim me procedurën e përcaktuar në nenin 22 e vijues të ligjit 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar dhe për këtë shkak, Komisioneri ka kërkuar revokimin e tij. Njësia përgjegjëse, përpara daljes së vendimit të Komisionerit, ka zhvilluar konkurimin për këtë pozicion pune dhe në përfundim të tij, punonjësja \*\*\*\*\* me aktin nr.226, dt.22.01.2016 është emëruar “*nëpunëse civile në periudhë prove*” në pozicionin “*Specialiste Finance*”, në Njësinë Administrative Fushë-Krujë. Zhvillimi i

procedurës së konkurimit për këtë pozicion pune, presupozon revokimin e aktit administrativ nr.94, dt.25.06.2015.

✓ Në Njësinë Administrative Thumanë:

✓ Në rastet e punonjësve, si më poshtë:

1. Me Urdhrin nr.115, dt.20.10.2015, të Kryetarit të Bashkisë, punonjësi \*\*\*\*\* me detyrë “*Inspektori i Zyrës së Tatim-Taksave*”, është larguar nga ky pozicion dhe i është ndërprerë marrëdhënia e punës, bazuar në Urdhrin nr.71, dt.15.9.2015 të Kryetarit të Bashkisë Krujë “*Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Krujë për periudhën e ristrukturimit*” dhe nenit 143/1 dhe 145 të ligjit nr. 7961, dt.12.7.1995 “*Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë*”, i ndryshuar.
2. Me Urdhrin nr.115, dt.20.10.2015, të Kryetarit të Bashkisë, punonjësja \*\*\*\*\* me detyrë “*Juriste*”, është larguar nga ky pozicion dhe i është ndërprerë marrëdhënia e punës, bazuar në Urdhrin nr.71, dt.15.9.2015 të Kryetarit të Bashkisë Krujë “*Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Krujë për periudhën e ristrukturimit*” dhe nenit 143/1 dhe 145 të ligjit nr. 7961, dt.12.7.1995 “*Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë*”, i ndryshuar.
3. Me Urdhrin nr.115, dt.20.10.2015, të Kryetarit të Bashkisë, punonjësi \*\*\*\*\* me detyrë “*Administrator i Zyrës së Ndihmës Ekonomike*”, është larguar nga ky pozicion dhe i është ndërprerë marrëdhënia e punës, bazuar në Urdhrin nr.71, dt.15.9.2015 të Kryetarit të Bashkisë Krujë “*Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Krujë për periudhën e ristrukturimit*” dhe nenit 143/1 dhe 145 të ligjit nr. 7961, dt.12.7.1995 “*Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë*”, i ndryshuar.
4. Me Urdhrin nr.115, dt.20.10.2015, të Kryetarit të Bashkisë, punonjësi \*\*\*\*\* me detyrë “*Inspektor i Arsimit dhe Kulturës*”, është larguar nga ky pozicion dhe i është ndërprerë marrëdhënia e punës, bazuar në Urdhrin nr.71, dt.15.9.2015 të Kryetarit të Bashkisë Krujë “*Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Krujë për periudhën e ristrukturimit*” dhe nenit 143/1 dhe 145 të ligjit nr. 7961, dt.12.7.1995 “*Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë*”, i ndryshuar.

Pavarësisht faktit që këto marrëdhënie pune janë ndërprerë tashmë, duke qenë se kemi të bëjmë me marrëdhënie pune administrative (*pozicioni i punës i punonjësit i përket shërbimit civil*), që rregullohen nga ligji për shërbimin civil, si bazë ligjore për ndërprerjen e tyre duhej cituar neni 22 i ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, dhe dispozita përkatëse e Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë.

Sa më sipër, arrihet në përfundimin se aktet për përfundimin e marrëdhënies së punësimit të punonjësve të mësipërm kanë dalë në kundërshtim me shkronjën”d” të nenit 109 të ligjit nr.44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*”.

Për këtë arsye, njësia e burimeve njerëzore të institucionit duhet të drejtojë procesin për shfuqizimin e pjesëshëm të këtyre akteve, në të cilat duhet të ndryshohet shkaku ligjor nga ana e Kryetarit të Bashkisë Krujë, veprim i cili do të ketë pasoja vetëm për të ardhmen sipas përcaktimeve të nenit 113 të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”. Aktet e ndryshuara duhet të bëhen pjesë e dosjes së personelit për këta punonjës.

- Me Urdhrin nr.138, dt.27.11.2015 të Kryetarit të Bashkisë, punonjësja \*\*\*\*\* me detyrë “*Inspektore Buxheti*”, është larguar nga ky pozicion me kërkesën e saj nr.2447, dt.11.11.2015. Akti administrativ i cituar më sipër ka dalë përpara se të dalë vendimi i Komisionerit për përfundimin e mbikëqyrjes.
- Me Vendimin nr.51, dt.01.09.2015 të Kryetarit të Bashkisë, punonjësi \*\*\*\*\* me detyrë “*Inspektore i Tatim-Taksave*”, është larguar nga ky pozicion me kërkesën e tij nr.38, dt.01.09.2015. Akti administrativ i cituar më sipër ka dalë përpara se të dalë vendimi i Komisionerit për përfundimin e mbikëqyrjes.
- Me Urdhrin nr.52, dt.01.09.2015 të Kryetarit të Bashkisë, punonjësi \*\*\*\*\* me detyrë “*Përgjegjës i Zyrës së Administrimit të Tokës*”, është larguar nga ky pozicion me kërkesën e tij nr.1676, dt.1.09.2015. Akti administrativ i cituar më sipër ka dalë përpara se të dalë vendimi i Komisionerit për përfundimin e mbikëqyrjes.
- Njësia përgjegjëse pasi ka verifikuar nivelin arsimor të punonjësit \*\*\*\*\* , sipas rekomandimit të pikës 4 dhe 8 të Vendimit të Komisionerit, ka nxjerrë aktin e deklaramit të statusit të punësimit si nëpunës civil në periudhë prove, nr.1916/3 Prot., dt.23.09.2016 në pozicionin “*Përgjegjës i Sektorit të Financës*”, për këtë punonjës, pranë Njesisë Administrative Thumanë, bazuar në nenin 67, pika 4 të ligjit nr.152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar. Me kryerjen e këtyre veprimeve administrative që kanë sjellë nxjerrjen e aktit të mësipërm, presupozohet i revokuar akti i deklaramit të statusit nëpunës civil, nr.121, dt.16.06.2014, për punonjësin \*\*\*\*\*.

✓ Në Njësinë Administrative Bubq:

1. Me Urdhrin nr.115, dt.20.10.2015, të Kryetarit të Bashkisë, punonjësja \*\*\*\*\* me detyrë “*Juriste*”, është larguar nga ky pozicion dhe i është ndërprerë marrëdhënia e punës, bazuar në Urdhrin nr.71, dt.15.9.2015 të Kryetarit të Bashkisë Krujë “*Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Krujë për periudhën e ristrukturimit*” dhe nenit 143/1 dhe 145 të ligjit nr. 7961, dt.12.7.1995 “*Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë*”, i ndryshuar.

Pavarësisht faktit që kjo marrëdhënie pune është ndërprerë tashmë, duke qenë se jemi përpara një marrëdhënie pune administrative (*pozicioni i punës i punonjësit i përket shërbimit civil*), që rregullohet nga ligji për shërbimin civil, si bazë ligjore për ndërprerjen e saj duhej cituar neni 22 i ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i

ndryshuar, dhe dispozita përkatëse e Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë.

Sa më sipër, arrihet në përfundimin se akti për përfundimin e marrëdhënies së punësimit të punonjësit të mësipërm ka dalë në kundërshtim me shkronjën”d” të nenit 109 të ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

Për këtë arsye, njësia e burimeve njerëzore të institucionit duhet të drejtojë procesin për shfuqizimin e pjesshëm të këtij akti, në të cilin duhet të ndryshohet shkaku ligjor nga ana e Kryetarit të Bashkisë Krujë, veprim i cili do të ketë pasoja vetëm për të ardhmen sipas përcaktimeve të nenit 113 të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”. Akti i ndryshuar duhet të bëhet pjesë e dosjes së personelit për këtë punonjëse.

✓ Në Njësinë Administrative Nikël:

- Njësia përgjegjëse pasi është njohur me rekomandimet e Projektraportit të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, dt.28.01.2016 (*parregullsia në emërimin e punonjësës \*\*\*\*\* i është bërë e ditur edhe gjatë periudhës së mbikëqyrjes*), pas përfundimit të procedurës së parashikuar në nenin 22 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, punonjësja \*\*\*\*\* me aktin nr.808, dt.01.03.2016 është emëruar “Nëpunëse civile në periudhë prove” në pozicionin “Inspektore e Ndhmës Ekonomike” në Njësinë Administrative Nikël. Kjo procedurë administrative presupozon se akti administrativ nr.33, dt.01.06.2015 është konstatuar i pavlefshëm.
4. Lidhur me rekomandimin e Komisionerit të materializuar në pikën 5 të pjesës urdhëruese të vendimit, u konstatua se, me Vendimin nr.21, dt.31.05.2015 “Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Krujë”, të Kryetarit të Bashkisë Krujë, është vendosur miratimi i Strukturës Organizative të Bashkisë Krujë dhe Njësiave Administrative në varësi të saj. Nga këqyrja e kësaj strukture rezulton se nuk është përfshirë Inspektoriati Ndërtimor Urbanistik. Kjo njësi e krijuar në bazë të ligjit 183/2014, “Për disa ndryshime e shtesa në ligjin nr.9780, dt. 16.7.2007 “Për inspektimin e ndërtimit”, i ndryshuar, nuk përfshihet në fushën e veprimit të ligjit për shërbimin civil. Ndodhur në këto kushte, të gjithë nëpunësit e këtij inspektoriati që më parë kanë përfituar të drejtat që i jepte ligji 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, nuk janë nëpunës civil, për më tepër nuk rezultojnë më në strukturën aktuale të miratuar me Vendimin nr.21, dt.31.05.2015 “Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Krujë.
5. Njësia përgjegjëse në zbatim të vendimit të Komisionerit, e konkretisht pikës 6 të pjesës urdhëruese të tij, ka nxjerrë aktet e mëposhtme:
- Aktin nr.1916/3, dt. 23.09.2016 , për deklarimin e punonjësës \*\*\*\*\* nëpunëse civile në pozicionin e punës “Juriste” në Njësinë Administrative Thumanë, bazuar në nenin 67, pika 3 të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil” , i ndryshuar. Deklarimi i statusit të punësimit nga njësia përgjegjëse është bërë pasi është konstatuar se

punonjësja ka qenë e punësuar në të njëjtin vend pune për një periudhë më shumë se një vit. (Fillimi i marrëdhënies së punës dt.29.07.2011).

- Aktin nr.1916/2, dt. 23.09.2016, për deklarimin e punonjësës \*\*\*\*\* nëpunëse civile në pozicionin e punës “*Inspektore veterinerë*” në Njësinë Administrative Thumanë, bazuar në nenin 67, pika 3 të ligjit nr.152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar. Deklarimi i statusit të punësimit nga njësia përgjegjëse është bërë pasi është konstatuar se punonjësja ka qenë e punësuar në të njëjtin vend pune për një periudhë më shumë se një vit. (Fillimi i marrëdhënies së punës dt.04.07.2007).
  - Aktin nr.1916/6, dt. 23.09.2016 , për deklarimin e punonjësës \*\*\*\*\* nëpunëse civile në periudhë prove në pozicionin e punës “*Përgjegjëse e Sektorit të Tatim Taksave*” në Njësinë Administrative Thumanë, bazuar në nenin 67, pika 4 të ligjit nr.152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar. Deklarimi i statusit të punësimit nga njësia përgjegjëse është bërë pasi është konstatuar se punonjësja ka qenë e punësuar në të njëjtin vend pune për një periudhë më pak se një vit. (Fillimi i marrëdhënies së punës dt.02.09.2013).
  - Njësia përgjegjëse nuk ka zbatuar rekomandimin e Komisionerit për nxjerrjen e aktit të deklarimit të statusit të punësimit nëpunëse civile në periudhë prove në pozicionin “*Administratore e Zyrës së Ndihmës Ekonomike*” për punonjësën \*\*\*\*\* , sepse punonjësja me Urdhrin nr.116, dt.20.10.2015, të Kryetarit të Bashkisë, me objekt “*Lirim nga shërbimi civil*”, është larguar nga detyra përpara daljes së vendimit të Komisionerit. Nga dokumentacioni i administruar në dosjen administrative, u konstatua fakti, se kjo mosmarrëveshje administrative ishte shqyrtuar nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, por vendimi nuk ka marrë formë të prerë. Pavarësisht këtij fakti, njësia përgjegjëse kishte detyrimin të nxirrte aktin e deklarimit të statusit të punësimit për këtë punonjëse, sepse ajo i plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 67, pika 4 të ligjit nr.152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar.
  - Me Vendimin nr.56, dt.16.09.2015 të Kryetarit të Bashkisë, punonjësi \*\*\*\*\* me detyrë “*Specialist Pyjesh*”, në Njësinë Administrative Thumanë është larguar nga ky pozicion me kërkesën e tij nr.435, dt.14.09.2015. Akti administrativ i cituar më sipër ka dalë përpara se të dalë vendimi i Komisionerit për përfundimin e mbikëqyrjes.
6. Njësia përgjegjëse, në zbatim të pikës 7 të vendimit të Komisionerit, pasi ka verifikuar dhe vlerësuar si pozicione të shërbimit civil, pozicionin “*Inspektor në Drejtorinë e Financës*” dhe “*Inspektor licensimi në Drejtorinë e Tatim-Taksave*”, ka nxjerrë aktet e mëposhtme për deklarimin e statusit të punësimit:
- Aktin nr.1916/16, dt.23.09.2016, të deklarimit të statusit “*Nëpunës civil*” për punonjësën \*\*\*\*\* , në pozicionin “*Inspektore Finance*” në Njësinë Administrative Fushë-Krujë.
  - Aktin nr.1916/17, dt.23.09.2016, të deklarimit të statusit “*Nëpunës civil*” për punonjësën \*\*\*\*\* , në pozicionin “*Inspektore në Drejtorinë e Tatim- Taksave*” në Njësinë Administrative Fushë-Krujë.

Aktet e mësipërme janë në përputhje me ligjin, sepse nga vërtetimet e datave 25.05.2015, provohet se këto punonjëse kanë më shumë se një vit në pozicione pune pjesë e shërbimit civil dhe bazuar në nenin 67, pika 3 e ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar janë deklaruar nëpunës civilë. Konkretisht punonjësja \*\*\*\*\* ka filluar punë në datë 02.11.1992 dhe punonjësja \*\*\*\*\* në datë 19.02.2001, në të njëjtin pozicion pune ku ato janë deklaruar nëpunëse civile.

7. Lidhur me rekomandimin e Komisionerit të materializuar në pikën 8 të pjesës urdhëruese të vendimit, grupi i punës konstatoi se:

- Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil në pikën 8 ka rekomanduar ndryshimin e aktit të deklarimit të statusit të punësimit nr.28, dt.01.04.2013 për punonjësën \*\*\*\*\* nga nëpunës civil në nëpunës civil në periudhë prove, për shkak se nëpunësi nuk plotësonte kushtet për të qenë nëpunës civil sipas përcaktimeve të nenit 67 pika 4 të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Nga dokumentacioni i administruar, rezulton se “*de jure*” nga ana e njësisë përgjegjëse nuk është vepruar për rregullimin e kësaj situate në përputhje me rekomandimin e Komisionerit, por “*de facto*”, punonjësi është trajtuar si nëpunës civil në periudhë prove. Ai ka kryer ciklin e detyrueshëm të trajnimit pranë Shkollës Shqiptare të Administratës Publike në periudhën 15-19 Shkurt 2016, (*detyrim i përcaktuar në nenin 24 të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar*) dhe është vlerësuar në testin përfundimtar me 22 pikë. Në përfundim të periudhës së provës ka dalë akti e deklarimit të statusit të punësimit nr.1183, dt.01.04.2016, për nëpunësin \*\*\*\*\* në pozicionin specialist (*veteriner*). Kjo mangësi formale nga ana e njësisë përgjegjëse të Bashkisë Krujë duhet të kihet parasysh në të ardhmen, me qëllim që administrimi i të gjitha proceseve të administrimit të shërbimit civil të bëhet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.

- Njësia përgjegjëse e Bashkisë Krujë nuk e ka ndryshuar aktin e deklarimit të statusit të punësimit nr.1916/15, dt.23.09.2016, për nëpunësen \*\*\*\*\* sipas rekomandimit të Komisionerit, për arsye se provoi me anë të Vendimit nr.42, dt.01.08.2011, se punonjësja kishte më shumë se një vit në atë pozicion pune e për rrjedhojë plotësonte kriteret e përcaktuara të nenit 67 pika 3 të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, për të përfituar statusin “*nëpunës civil*” në pozicionin “Përgjegjëse e Sektorit të Shërbimeve” në Njësine Administrative Bubq.
- Njësia përgjegjëse pasi ka verifikuar nivelin arsimor të punonjësit \*\*\*\*\* (*ka mbaruar Fakultetin Ekonomik në Universitetin “Aleksandër Xhuvani” Elbasan*), në përputhje me rekomandimin e Komisionerit, ka nxjerrë aktin e deklarimit të statusit të punësimit si nëpunës civil në periudhë prove nr.1916/3 Prot., dt.23.09.2016, në pozicionin “Përgjegjës i Sektorit të Financës”, për këtë punonjës, pranë Njesisë Administrative Thumanë.

8. Në lidhje me 3 pozicionet e plotësuara nëpërmjet konkurrimit, për të cilat Bashkia Krujë është rekomanduar që të vijojë procedurat e kërkuara nga ligji, për të përfunduar procesin

e periudhës së provës, rezulton se me Njoftimin nr.2502/1, datë 29.12.2015 bazuar në nenin 24 të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, Bashkia Krujë i ka kërkuar ASPA-s, kryerjen e ciklit të detyrueshëm të trajnimit për nëpunësit civilë në periudhë prove, \*\*\*\*\*; \*\*\*\*\* dhe \*\*\*\*\* , sipas rekomandimeve të vendimit të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.

9. Lidhur me rekomandimin e Komisionerit të materializuar në pikën 10 të pjesës urdhëruese të vendimit, rezulton se, pas miratimit të Vendimit nr.81, dt.30.12.2015 “Për miratimin e numrit të punonjësve të Bashkisë Krujë dhe Njësive Administrative të saj me 310 punonjës”, njësia përgjegjëse bazuar në detyrimin ligjor të parashikuar në nenin 10 të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, pasi ka verifikuar mënyrën dhe kohën e fillimit të marrëdhënieve të punës të nëpunësve të ish Komunës Thumanë (njësia përgjegjëse e kësaj komune nuk kishte zhvilluar asnjë procedurë ligjore) në zbatim të rekomandimeve të vendimit të Komisionerit ka plotësuar dosjet individuale me të gjithë të dhënat sipas kërkesave të ligjit. Për nëpunësit që plotësonin kërkesat e parashikuara në nenin 67 të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, ka përfunduar procesin e deklarimit të statusit të punësimit. Ky fakt provohet nga aktet e deklarimit të statusit të punësimit të administruara nga grupi i punës në dosjen përkatëse të verifikimit.
10. Lidhur me rekomandimet e Komisionerit për përshkrimet e punës dhe dosjet e personelit të materializuara respektivisht në pikat 11 dhe 12 të vendimit, rezultoi se formati i përshkrimit të punës është hartuar sipas lidhjes 4, bashkëlidhur Vendimit nr. 142, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura” dhe është nënshkruar nga nëpunësi civil, eprori direkt, si dhe nga titullari i institucionit. Dosjet e personelit ishin plotësuar me aktet që mungonin si dëshmi penaliteti dhe raporte mjeko-ligjore të nëpunësve civilë.
11. Në lidhje me informacionet e ardhura në adresë të Komisionerit, të cilat janë trajtuar gjatë mbikëqyrjes, grupi i punës konstatoi se, njësia përgjegjëse ka nxjerrë vendimin e lirimt nga shërbimi civil nr.116, datë 20.10.2015, për nëpunësen \*\*\*\*\* , për arsye të ristrukturimit të institucionit dhe ka zbatuar detyrimet ligjore të parashikuara në pikën 7 të nenit 50 të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, sipas rekomandimit të pikës 13 të vendimit të Komisionerit.

Rasti i nëpunëses \*\*\*\*\* , për të cilën është kërkuar rifillimi i procedurës sipas parashikimeve të nenit 50 të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, rezulton si vijon:

Nisur nga përmbajtja e shkresës nr.2154 Prot., dt.02.06.2016, të Drejtorit të Burimeve Njerëzore të Bashkisë Krujë, nëpunësja \*\*\*\*\* është liruar nga shërbimi civil si pasojë e ristrukturimit të institucionit dhe është regjistruar në listë pritjeje sipas përcaktimeve të nenit 50 dhe 66 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.171, dt.26.03.2014, “Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirin nga shërbimi civil”.



Përsa i përket nëpunësit \*\*\*\*\* , rasti i tij është trajtuar në mënyrë të plotë në pjesën arsyetuese për zbatimin e pikës 3 të vendimit nr.30. dt.31.03.2016 të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.

Sa më sipër, u verifikua reagimi i njësisë përgjegjëse për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në përmbajtjen e raportit të mbikëqyrjes, u mbajt procesverbali i konstatimit dhe përfundimisht, arrij në konkluzionin se Vendimi nr. 30, datë 31.03.2016, *“Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar ligjshmërinë gjatë administrimit të shërbimit civil, në Bashkinë Krujë”*, është zbatuar nga ana e subjektit, **Bashkia Krujë**.

#### **Për këto arsye:**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11 pika 1, 14 dhe 15, të ligjit nr.152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, si dhe në nenin 34 të Rregullores *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

#### **V E N D O S A:**

1. Përfundimin e procesit të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në institucionin, Bashkia Krujë.
2. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e njësisë përgjegjëse, duke zbatuar rekomandimet e Vendimit nr. 30, datë 31.03.2016 , *“Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar ligjshmërinë gjatë administrimit të shërbimit civil, në Bashkinë Krujë”*.
3. Për këtë vendim të njoftohet institucioni, Bashkia Krujë dhe Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në Kuvendin e Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

#### **KOMISIONERI**

**Pranvera STRAKOSHA**